



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 23
1 qershor – 7 qershor 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	11 / 12	92%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%

SHKODËR		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
	Kukës	Kukës	14 / 14	100%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	8 / 9	89%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	5 / 6	83%
	VLORË	Vlorë	Vlorë	22 / 22
Sarandë			10 / 10	100%
Delvinë			5 / 5	100%
Fier		Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
Gjirokastër		Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	424 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 23

	JAVA 23
Diarre pa gjak	1654
Diarre me gjak	0
Inf. resp. të sipërme	6801
Inf. resp. të poshtme	2481
Rash me temperaturë	43
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	424
% e Njësive Raportuese	99% (424/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 6 raste

Fier– 12 raste


Vlorë – 17 raste

Pogradec– 6 raste


Dibër – 1 rast

Mat – 1 rast

Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.




Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grupmoshave.




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 23 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 22.

Grafiku 3. Trendi në kohë i diarreve pa gjak sipas javëve.




Grafiku 4. Shpërndarja e diarreve pa gjak sipas grup-moshave.





Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 23 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 22.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 23 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 23 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).**Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 22/2026 dhe 23/ 2026. Incidenca (raste/10.000).**


Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 5-23 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 23 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i madh i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 22-23/2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Dibër, Kolonjë dhe Vlorë ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda, 2026.

- Në Republikën Demokratike të Kongos (provincat Ituri, Kivu i Veriut dhe Kivu i Jugut) janë raportuar gjithsej 381 raste të konfirmuara, përfshirë 64 vdekje të lidhura me sëmundjen. Krahastuar me raportin e mëparshëm janë regjistruar 18 raste të reja dhe 2 vdekje të tjera.
- Në Ugandë janë raportuar 16 raste të konfirmuara, përfshirë 1 vdekje.
- Analizat paraprake gjenomike tregojnë se sekuencat virale të identifikuar janë të ndryshme nga ato të shpërthimeve të mëparshme të virusit Bundibugyo në vitet 2007 dhe 2012.
- Më 17 maj 2026, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli se shpërthimi i sëmundjes Ebola të shkaktuar nga virusi Bundibugyo përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC).
- Më 18 maj 2026, Qendra Afrikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (Africa CDC) e shpalli situatën një Emergjencë të Sigurisë Shëndetësore Kontinentale.
- Bazuar në informacionin aktual dhe pasiguritë që ende ekzistojnë lidhur me këtë shpërthim, rreziku i infektimit për personat nga vendet e Bashkimit Evropian/Zonës Ekonomike Evropiane (BE/ZEE) që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet i ulët.
- Për popullatën që jeton në vendet e BE/ZEE, rreziku i infektimit vlerësohet shumë i ulët, për shkak të probabilitetit shumë të vogël të importimit të rasteve dhe transmetimit dytësor.
- Ky vlerësim i rrezikut do të rishikohet në përputhje me informacionet e reja që do të bëhen të disponueshme.
- Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) vijon të monitorojë situatën përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Malaria nga Plasmodium falciparum – Mayotte, Francë, 2026.

- Që nga janari 2026 dhe deri më 21 maj 2026, në Mayotte, Francë, janë raportuar gjithsej 171 raste me malarie.
- Nga këto, 63 raste dyshohet se janë autoktone, pra infeksioni është marrë lokalisht dhe jo përmes udhëtimit në zona të tjera endemike.
- Një rritje e ndjeshme e numrit të rasteve është vërejtur gjatë javëve epidemiologjike 18–20 (27 prill–17 maj 2026), me një mesatare prej 25 rastesh në javë, krahasuar me rreth 6 raste në javë gjatë periudhës së mëparshme të vitit.

- Shumica e rasteve të fundit janë raportuar në komunat jugore të Mayotte, veçanërisht në Chirongui.
- Të gjitha rastet e raportuara janë shkaktuar nga Plasmodium falciparum, forma më e rëndë dhe potencialisht më e rrezikshme e malaries.
- Rreziku i infektimit për udhëtarët që vizitojnë Mayotte vlerësohet i ulët, ndërsa rreziku i transmetimit të mëtejshëm në Evropën kontinentale konsiderohet shumë i ulët.
- Udhëtarët dhe banorët këshillohen të zbatojnë masa të shtuara mbrojtëse kundër pickimeve të mushkonjave, duke përfshirë përdorimin e repelentëve, rrjetave mbrojtëse dhe veshjeve që mbulojnë trupin.
- Përdorimi i medikamenteve profilaktike kundër malaries mund të merret në konsideratë sipas rekomandimeve kombëtare përkatëse.

Mpox në BE/ZEE, Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – 2026

- Gjatë muajit prill 2026, 102 raste me mpox të shkaktuara nga virusi i lisë së majmunit (MPXV clade I) janë raportuar nga 11 vende të Bashkimit Evropian/Zonës Ekonomike Evropiane (BE/ZEE), duke treguar një trend relativisht të qëndrueshëm krahasuar me muajt e mëparshëm.
- Në të njëjtën periudhë, janë raportuar 23 raste me mpox të shkaktuara nga MPXV clade II nga shtatë vende, duke vijuar trendin në rënie të vërejtur gjatë muajve të fundit.
- Transmetimi për të dy kladet ndodh kryesisht brenda rrjeteve të meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM), me qarkullim të vazhdueshëm të virusit në vendet e BE/ZEE. Shumica e rasteve janë raportuar te individë të pavaksinuar.
- Ashpërsia e sëmundjes mbetet përgjithësisht e lehtë, me nivele të ulëta shtrimi në spital të raportuara për të dy kladet e virusit.
- Me fillimin e sezonit të pranverës dhe verës, si dhe rritjen e udhëtimeve dhe organizimit të grumbullimeve masive, ekziston rreziku i përhapjes së mëtejshme të infeksionit.
- Autoritetet e shëndetit publik vijnë monitorimin e situatës dhe rekomandojnë rritjen e ndërgjegjësimit, identifikimin e hershëm të rasteve, gjurmimin e kontakteve dhe vaksinimin e grupeve në rrezik sipas udhëzimeve përkatëse.

Përhapja e infeksionit nga Dermatophilus congolensis, kryesisht te meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM) – BE/ZEE, 2026.

- Tre vende kanë raportuar gjithsej 50 raste të infeksioneve të lëkurës të shkaktuara nga Dermatophilus congolensis. Rastet janë raportuar përmes sistemit EpiPulse nga Franca dhe Gjermania, si dhe në publikime shkencore nga Spanja.

- Rastet e raportuara kanë qenë përgjithësisht të lehta, me shërim të plotë dhe pa komplikacione pas trajtimit me antibiotikë.
- Shumica e rasteve janë identifikuar te meshkujt që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM), të cilët kishin frekuentuar sauna ose ambiente të dedikuara për aktivitete seksuale. Pjesa më e madhe e diagnozave është vendosur në periudhën dhjetor 2025 – maj 2026.
- *Dermatophilus congolensis* është një bakter që tradicionalisht lidhet me infeksionet te kafshët dhe vetëm rrallëherë shkakton sëmundje te njerëzit.
- Raportimet e fundit mund të sugjerojnë një ndryshim në mënyrën e transmetimit të këtij bakteri, me të dhëna që mbështesin mundësinë e transmetimit nga njeriu tek njeriu, veçanërisht në ambiente me temperatura të larta dhe lagështi të shtuar.
- Autoritetet e shëndetit publik vijnë monitorimin e situatës për të kuptuar më mirë karakteristikat epidemiologjike të këtij infeksioni dhe rrugët e mundshme të transmetimit.

Grupim shumë-shtetëror i rasteve me *Salmonella* Stanley ST2045

- Po hetohet një shpërthim shumë-shtetëror i shkaktuar nga *Salmonella* Stanley ST2045, i cili deri tani përfshin 83 raste të raportuara në periudhën nga fundi i dhjetorit 2025 deri në maj 2026. Shpërthimi mbetet ende aktiv.
- Fëmijët dhe të rinjtë përfaqësojnë një pjesë disproporcionale të rasteve të raportuara.
- Rastet e konfirmuara, me analiza gjenomike të lidhura me shtamin e shpërthimit të identifikuar fillimisht në Danimarkë, janë raportuar në Austri, Çeki, Danimarkë, Estoni, Francë, Gjermani, Lituani, Holandë dhe Mbretërinë e Bashkuar.
- Hetimet epidemiologjike dhe mikrobiologjike të kryera në vendet e prekura sugjerojnë se burimi i mundshëm i infeksionit mund të jetë konsumi i makaronave tip (instant noodles) dhe/ose produkteve të përpunuara të pulës.
- Ekziston mundësia që produktet e përfshira të kenë një përbërës të përbashkët të kontaminuar, i cili mund të ketë kontribuar në përhapjen e infeksionit në disa vende.
- Autoritetet kombëtare dhe evropiane të sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik po vijnë hetimet për identifikimin e burimit të saktë të kontaminimit, si dhe marrjen e masave për kontrollin e shpërthimit.